



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 5 datë 28.05.2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “FERMA E DIJES DHE
AGROTURIZMIT TË MOLLËVE”, ME VENDNDODHJE NË QATROM, BASHKIA
KORÇË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të mollëve”, me vendndodhje në Qatrom, Bashkia Korçë, me zhvillues Fondin Shqiptar të Zhvillimit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Korçë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANDIS SALLA



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E SHqipërisë", "MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL", and "DREKTORATI PËR ZHVILLIMIN RURAL".

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E SHqipërisë", "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT", "MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL", and "DREKTORATI PËR ZHVILLIMIN RURAL".

Nënshkruar më datë ___ / ___ / 2026